



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 183 Prot.

Tiranë, më 22.12 2017

**VENDIM Nr. 239, datë 13.12.2017**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërbimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.13, datë 13.12.2017, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të **projektit "HEC-et "Slabinjë 2B, Slabinjë 2C, Slabinjë 2D, Slabinjë 2D/1 dhe Slabinjë 2E" në zonën e Mokrës, Pogradec"**- subjekti "HIDROPOWER -ELEKTRIK" sh.p.k.. realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "K.A.E.XH." sh.p.k..

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të **projektit "HEC-et "Slabinjë 2B, Slabinjë 2C, Slabinjë 2D, Slabinjë 2D/1 dhe Slabinjë 2E" në zonën e Mokrës, Pogradec"**- subjekti "HIDROPOWER -ELEKTRIK" sh.p.k., realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "K.A.E.XH." sh.p.k.
2. Subjekti "HIDROPOWER-ELEKTRIK" sh.p.k., duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me shoqëri të licencuar në arkeologji, e cila duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin **"HEC-et "Slabinjë 2B, Slabinjë 2C, Slabinjë 2D, Slabinjë 2D/1 dhe Slabinjë 2E" në zonën e Mokrës, Pogradec"**, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë shoqëri.
3. Subjekti "HIDROPOWER-ELEKTRIK" sh.p.k. dhe shoqëria e cila do të zbatojë punimet ndërtimore, duhet të **mos kryejnë asnjë lloj punimi apo lëvizje, në zonën e shtrirjes së traktit të rrugës së periudhës Romake, i cili gjendet përgjatë Kanionit të lumit Shkumbin**, me qëllim ruajtjen dhe mosdëmtimin e tij dhe shmangjen e çdo lloj ndikimi që mund të ketë mbi të, zbatimi i punimet për ndërtimin e HECE-ve të sipërpërmendur.